

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-226/2014

**Prishtinë,
26 Tetor 2016**

Në çështjen juridike të:

M. P.

I përfaqësuar nga L. P.

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, kryetar i kolegjit, Anna Bednarek dhe Krassimir Mazgalov anëtarë të kolegjit, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/220/2013, të datës 27 nëntor 2013 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numër KPA30630), pas shqyrtimit të mbajtur më 26 Tetor 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

Ankesa e paraqitur nga **M.P.** kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës **KPCC/D/A/220/2013**, të datës **27 nëntor 2013** në lidhje me kërkesën e regjistruar në **AKP** me numër **KPA30630**, hedhet poshtë si e paafatshme.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 11 Prill 2007, L. M. P. (anëtar i familjes) në emër të babait të tij M. P. bartës i së drejtës pronësore, ka paraqitur kërkesë duke kërkuar ri-posedimin e ngastrave me numër 662/3 dhe 662/4 me sipërfaqe totale prej 75 ari, 66m², të cilat gjenden në vendin e quajtur Brezhanik në Bellopole, Pejë (tani e tutje “pronat e kërkuara”).
2. Kërkesa është regjistruar në AKP me numër KPA30630. Ai thekson se pronat janë humbur si rezultat i konfliktit të armatosur i cili ka ndodhur në Kosovë gjatë viteve 1998 dhe 1999, duke cekur 13 qershorin 1999 si datë të humbjes së pronës. Për më tepër, ai pohon se e ëma dhe babai i tij ishin bashkëpronar të pronës së kërkuar, por aktualisht ngastrat janë regjistruar në emër të dy personave të panjohur të cilët i kanë ndarë ato në dy pjesë të barabarta.
3. Për ta mbështetur kërkesën e tij, L.M.P. ka paraqitur dokumentet në vijim:
 - Kopjen e fletës poseduese nr. 197, të lëshuar më 18 maj 2004 nga Departamenti për pronë të paluajtshme dhe kadastër në Komunën e Pejës, në të cilën babai i tij figuron si bashkëpronar i pjesës 1/7 ideale të pronave të kërkuara;
 - Kopjen e autorizimit të dhënë nga M.P. dhe Z. P. për të afërmin e tyre G. P. duke e autorizuar këtë të fundit që t'i shesë pronat e kërkuara. Nënshkrimi i Z. P. në autorizim është legalizuar nga Gjykata e shkallës së parë në Beograd më 9 mars 2001 (Nr. 2841/01);
 - Kopjen e autorizimit të dhënë nga G.P. për R.R. për të nënshkruar në emrin e tij kontratën e shitblerjes lidhur me pronat e kërkuara dhe për t'i vërtetuar ato pranë Gjykatës Komunale të Pejës;

- Kopjen e kontratës së shitblerjes së pronës së paluajtshme të lidhur më 12 mars 2001 në mes R.R. duke vepruar në cilësi të përfaqësuesit të M. P. dhe Z. si shitës dhe T. H. si blerës. Nënshkrimet e personave të cilët kanë nënshkruar kontratën janë legalizuar pranë Gjykatës Komunale të Pejës më 15 mars 2001 dhe mbajnë numrin: Ov. 769/01. Në bazë të kontratës “1/2 e secilës” ngastër me numër 662/3 dhe 662/4 që përmbajnë pronat e kërkuara me sipërfaqe totale prej 0.37,83 ha i është shitur blerësit T. H.;
 - Kopjen e vendimit mbi trashëgiminë të lëshuar më 11 dhjetor 2008, në lëndën me numër O. 211/08 nga Gjykata Komunale e Pejës me të cilin M. P. është shpallur si trashëgimtar i vetëm ligjor i të ndjerës Z. P.;
 - Kopjen e certifikatës së vdekjes nr. E/6158/2006 të Z. P. të lëshuar më 15 nëntor 2006 nga Komuna e Pejës
4. Fillimisht, pronat e kërkuara janë vizituar më 17 tetor 2008, por njoftimi i kërkesës është konsideruar si i gabuar për shkak të arsyeve teknike. Më 17 korrik 2010, njoftimi është bërë përmes publikimit në gazetën e njoftimit të AKP-së nr.2 dhe përmes buletinit të pronës të UNHCR-së. Prandaj, njoftimi tjetër është bërë në 7 korrik 2010. Më 31 janar 2013, ekipi i njoftimit përsëri ka lokalizuar pronat e kërkuara dhe ka gjetur se ato janë kullosa dhe vend parkim të cilat ishin të zëna nga T.H.. Në vendin e inspektimit ekipi i verifikimit ka takuar J. A., i cili ka deklaruar se ai ishte duke e shfrytëzuar ngastrën nr. 662/3 dhe nuk ka pretenduar ndonjë të drejtë ligjore mbi pronat e kërkuara dhe ka nënshkruar njoftimin e pjesëmarrjes
 5. Sipas raportit të verifikimit të konsoliduar të përpiluar më 30 shtator 2013, dokumentet e dorëzuara janë verifikuar pozitivisht, përveç fletës poseduese nr. 197 dhe autorizimit të dhënë më 9 mars 2001.
 6. Më 27 nëntor 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (tani e tutje “KKPK”), përmes vendimit të tij KPCC/D/A/220/2013 (tani e tutje “vendimi i KKPK-së”) ka hedhur poshtë kërkesën pasi që bie jashtë juridiksionit të tij. Në arsyetim e vendimit, KKPK-ja ka sqaruar se paraqitësi i kërkesës ka dështuar që të tregojë se kërkesa e tij përfshin rrethanat që lidhen drejtpërdrejt apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur i vitit 1998-1999.
 7. Vendimi i KKPK-së i është dërguar L. P. më 25 prill 2014 dhe T. H. më 5 maj 2014. Më 30 qershor 2014, pala ankuese ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së.

Pretendimet e palës ankuese

8. Pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme e Kosovës që ta pranojë ankesën e tij dhe të marrë një vendim tjetër duke e njohur atë si pronarë të pronave të kërkuara. Në ankesë, ai ka theksuar se vendimi i KKKPK-së përmban gabime fundamentale dhe shkelje të rëndë të ligjit material dhe të procedurës.

Arsyetimi ligjor

9. Ankesa është e paafatshme. Neni 12.1 i Ligjit nr. 03/L-079 “mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale” (tani e tutje “Ligji nr. 03/L-079) parasheh si në vijim: *“Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës”*
10. Më 25 prill 2014, L. P. duke përfaqësuar babanë e tij M.P. i është dërguar vendimi i KKKPK-së në lidhje me kërkesën nr. KPA30630, prandaj afati për të paraqitur ankesë ka përfunduar më 25 maj 2016. Ankesa është paraqitur më 30 qershor 2014, prandaj jashtë afatit. Kjo do të thotë se ankesa është paraqitur jashtë afatit kohor të përcaktuar me ligj. Pala ankuese nuk ka dhënë asnjë arsye për paraqitjen e vonuar të ankesës dhe gjykata nuk ka mundur të gjejë asnjë arsye për vonesën. Prandaj, ankesa për këtë kërkesë është dashur të hedhet poshtë si e papranueshme mbi bazën e arsyeve procedurale të ligjit të lartpërmendur. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme nuk ka mundur t’i shqyrtojë pretendimet e paraqitura në ankesë.
11. Në bazë të asaj që u tha më lart dhe në pajtim me nenin 13.3.(b) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenit 195, paragrafit 1(a) të Ligjit mbi procedurën kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike

Në pajtim me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky Aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetar i kolegjit

Anna Bednarek, Gjyqtare e EULEX-it

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it